



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Zyra e Rregullatorit për Energji

Parimet e vendosjes së ngarkesave për gjeneratorët e rregulluar

2013



Pjesa I – Dispozitat e Përgjithshme	3
Neni 1 Hyrje	3
Neni 2 Fushëveprimi dhe qëllimi	3
Neni 3 Perkufizimet dhe interpretimet	3
Pjesa II – Parimet e Përbashkëta	5
Neni 4 Mos diskriminimi dhe pasqyrimi i kostove	5
Neni 5 Thjeshtësia dhe transparenca	5
Pjesa III – Metodologjia e Përcaktimit të Tarifave/Ngarkesave për Gjenerim	6
Neni 6 Baza e përcaktimit të ngarkesave	6
Neni 7 Alokimi i kostove në komponentin fiks dhe variabil	6
Neni 8 Dizajni i tarifave/ngarkesave	7
Kreu V – Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare	8
Neni 9 Gjuha zyrtare	8
Neni 10 Ndryshimi	8
Neni 11 Interpretimi	8
Shtojca Kostot e Gjenerimit	9
Alokimi i kostove në komponentin fiks dhe variabil	9
Ngarkesa për Kapacitet	11
Ngarkesa për Energji	12



PJESA I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Hyrje

Bazuar në Nenin 14 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185 dhe nenin 16 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”) ka aprovuar Parimet për Ngarkesat e gjenerimit (më tutje “Parimet”), të cilët do të shërbejnë për Gjeneratorët e rregulluar për ngarkesat e vëna për prodhimin e energjisë elektrike.

Neni 2

Fushëveprimi dhe qëllimi

- 1** Këto parime i përcaktojnë parimet mbi të cilat gjeneratorët e rregulluar duhet të hartojnë propozimet për ngarkesa për shitjen e energjisë (“metodologjia e përcaktimit të ngarkesave për gjeneratorët e rregulluar”), të cilat do t’i parashtrohen ZRRE-së për aprovim. Bordi i ZRRE-së pret që Metodologjitë e propozuara të jenë në pajtim me këto parime. Në të kundërtën, Bordi i Rregullatorit do të kërkojë një arsyetim të detajuar për këtë mospërputhje që të vendosë lidhur me aprovimin e këtyre Metodologjive.
- 2** Këto parime duhet të lexohen në përputhje me Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike dhe Rregullin për Vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit.

Neni 3

Përkufizimet dhe interpretimet

- 1** Shprehjet e përdorura në këto Parime kanë kuptimet që janë përcaktuar me Ligjin për Rregullatorin e energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për energjinë elektrike dhe Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit apo në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
 - 1.1** “Të hyra e lejuara maksimale” nënkupton të hyrat që mbulohen nga gjeneratori i rregulluar përmes ngarkesave për ofrimin e energjisë dhe kapacitetit për FPEE në, si dhe çdo e hyrë tjetër e përcaktuar nga rregullatori;
 - 1.2** ‘Gjenerator i rregulluar’ nënkupton gjeneratorin që obligohet sipas Ligjit për Energji Elektrike të furnizojë Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike (FPEE-në) me çmim të rregulluar;
 - 1.3** “Gjenerator” nënkupton stabilimentet gjeneruese të paraqitura në licencën e Prodhimit të Energjisë Elektrike;
 - 1.4** “Caku i disponibilitetit” nënkupton nivelin e caktuar të kapacitetit në dispozicion brenda vitit, i cili përshtatet për mirëmbajtjet e pritshme, daljet e detyruara jashtë sistemit dhe shkaqe të tjera të mosdisponibilitetit;



- 1.5** “Kapaciteti në dispozicion” nënkupton kapacitetin e gjeneratorëve të rregulluar që është në dispozicion për prodhim të energjisë elektrike;
- 1.6** “Kostot fikse” nënkupton kuptimin që i është dhënë në Nenin 7
- 1.7** “Kostot variabile” nënkupton kuptimin që i është dhënë në Nenin 7;



PJESA II – PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 4

Pasqyrimi i kostos dhe mos diskriminimi

- 1** Metodologjia e ngarkesave e referuar ne Nenin 2 si me lartë, do të duhej të rezultonte që ngarkesave e gjeneratorit të rregulluar apo oferta e tyre për ngarkesat për shitjen e kapaciteteve dhe/apo energjisë drejt cilitdo blerës:
 - 1.1** Të reflektoj koston fikse dhe/ose variabile të shkaktuar nga ajo shitje; dhe
 - 1.2** Të shmang diskriminimin e paligjshëm në alokimin e këtyre ngarkesave në mes të blerësve të ndryshëm .

Neni 5

Thjeshtësia dhe transparencja

- 1** Ngarkesat duhet të jenë sa më të thjeshta, transparente dhe të parashikueshme sa me shumë që të jetë e mundur, e njëherit të pasqyrojnë dhe të reflektojnë shpenzimet e shkaktuara në gjenerimin e energjisë elektrike nga gjeneratorët e rregulluar.
- 2** Ngarkesat duhet të marrin parasysh zhvillimet e ardhshme në strukturën e sektorit të energjisë elektrike dhe të lejojnë rregullim më të sofistikuar krahas zhvillimit të tregut.



PJESA III – METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE/NGARKESAVE PËR GJENERIM

Neni 6

Baza e përcaktimit të ngarkesave

- 1** Në përcaktimin e bazës së duhur për përcaktimin e ngarkesave për gjenerim duhet të merr parasysh kostot afatgjata të mirëmbajtjes së një gjenerimi të sigurt, të sigurt dhe të besueshëm në mënyrë që të përmirësohet parashikueshmëria, stabiliteti dhe pasqyrimi i kostos në aspektin afatgjatë.
- 2** Në hartimin e Metodologjisë për përcaktimin e ngarkesave për gjenerim, gjeneratorët duhet të merr parasysh kostot afatgjate, marginale, kostot e shmangura të gjenerimit që shkaktohen nga masat për menaxhimin e anës së kërkesës.

Neni 7

Alokimi i kostove në komponentin fiks dhe variabil

- 1** Të hyrat e lejuara maksimale duhet të alokohen në kosto fikse dhe kosto variabile siç është e përcaktuar në Shtojcë .
- 2** Kosto variabile janë ato kosto që ndryshojnë me njësitë e furnizuara dhe do të përmbajnë:
 - 2.1** Komponentin variabil të kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes; dhe
 - 2.2** Komponentin variabile të kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill.
- 3** Kostot fikse do të llogariten si të hyra të lejuara maksimale minus kostot variabile.
- 4** Komponenti variabil i kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes do të vlerësohet duke iu referuar atyre kostove që nuk do të shkaktoheshin nëse njësitë e furnizuara në cilindo vit relevant do të ishin zero.
- 5** Komponenti variabil i kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill duhet:
 - 5.1** Në rastin kur ekziston marrëveshje furnizimi me thëngjill, të jetë e barabartë me ngarkesën variabile në këtë marrëveshje.
 - 5.2** Në rastin kur nuk ekziston marrëveshje furnizimi me thëngjill, të parallogaritet duke iu referuar atyre kostove të operatorit të minierës së thëngjillit që nuk do të shkaktoheshin nëse volumi i thëngjillit të furnizuar në cilindo vit relevant do të ishte zero.



Nenin 8

Dizajni i ngarkesave

- 1** Dizajni i tarifave duhet të përbehet prej tarifave/ngarkesave për kapacitet dhe tarifave/ngarkesave për energji.
- 2** Tarifat/ngarkesat për kapacitet duhet të caktohen në mënyrë që gjeneratorët e rregulluar:
 - 2.1** Ngarkesa për kapacitet të mbulojë kostot fikse të gjeneratorit të rregulluar, me kusht që kapaciteti gjenerues në dispozicion të plotësojë cakun e disponibilitetit të caktuar për gjeneratorin e rregulluar; dhe
 - 2.2** Ngarkesa për kapacitet të jetë në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga gjeneratori i rregulluar dhe të aprovuar nga rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me këto parime, të nxjerrë nga ZRRE.
- 3** Ngarkesat për kapacitet do të shprehen në euro për njësi të kapacitetit në dispozicion për orë. Ato do të paguhen në bazë mujore për secilën orë të kapacitetit në dispozicion për atë muaj. Asnjë ngarkesë nuk do të jetë obligative për t'u paguar nga FPEE për orët në të cilat nuk ka kapacitet në dispozicion.
- 4** Gjeneratorët e rregulluar do ti propozojnë ZRRE-së cakun e disponibilitetit që përdoret për të llogaritur ngarkesën për kapacitet brenda çdo viti, që do të marrë parasysh:
 - 4.1** Performancën e kaluar;
 - 4.2** Performancën e parashikuar; dhe
 - 4.3** Krahasimet me gjenerator të ngjashëm në Kosovë dhe gjetiu në Evropë.
- 5** ZRRE do ta aprovojë cakun e disponibilitetit të kapacitetit që përdoret për të llogaritur ngarkesën për kapacitet brenda çdo viti, gjatë aprovimit të ngarkesave/tarifave për gjeneratorët e rregulluar.
- 6** Gjeneratori i rregulluar do të caktojë ngarkesat për energji në mënyrë që:
 - 6.1** Ngarkesat për energji të mbulojnë kostot variabile të gjeneratorit të rregulluar, duke pasur parasysh njësitë që priten të furnizohen nga gjeneratori i rregulluar gjatë vitit relevant; dhe
 - 6.2** Ngarkesat për energji të jenë në pajtim me metodologjinë e zhvilluar nga gjeneratori i rregulluar e që aprovohet nga rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në përputhje me këto parime, të nxjerra nga rregullatori.
- 7** Ngarkesat për energji do të shprehen në euro për çdo njësi të furnizuar.



KREU V – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Gjuha zyrtare

Këto parime janë nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 10

Ndryshimi

ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të këtyre Parimeve.

Neni 11

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e këtyre Parimeve, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar



SHTOJCA - KOSTOT E GJENERIMIT

Alokimi i kostove në komponentin fikse dhe variabil

Neni 14 i Rregullës për Çmimet e Gjenerimit përcakton se si duhet të alokohen të hyrat e lejuara maksimale në kosto variabile dhe kosto fikse për aktivitetet e gjenerimit dhe minierës të cilat përshkruhen në vazhdim:

$$\mathbf{T\grave{e}\ hyrat\ e\ lejuara\ maksimale(MAR) = KF + KV}$$

Kostot variabile janë ato kosto që ndryshojnë me njësitë e furnizuara dhe do të përmbajnë: Komponentin variabil të kostove të lejuara operative, mirëmbajtjes dhe komponentin variabile të kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill.

$$\mathbf{KV = OPEX_{i\ lejuar}^{var} + LSC_{th\grave{e}ngjilli\ i\ lejuar}^{var}}$$

Kostot fikse do të llogariten nga formula e mësipërme e MAR-it, si të hyra të lejuara maksimale minus kostot variabile të paraqitura në vijim:

$$\mathbf{KF = MAR - KV, ose}$$

$$\mathbf{KF = MAR - OPEX_{i\ lejuar}^{var} - LSC_{th\grave{e}ngjilli\ i\ lejuar}^{var}}$$

Kur kemi kosto të përziera (fikse dhe variabile) do të përdoret çelësi i alokimit si % e komponentëve fikse dhe variabile.



Në tabelat në vijim janë bërë ndarjet e Kostove sipas komponentëve në fikse dhe variabile të ndërlidhura me gjeneratorët e rregulluar.

Kategoritë e kostove fikse	Shpjegime
<i>Kostot e stafit</i>	<i>Kostot e stafit bazohen kontrata dhe nuk ndryshojnë me prodhimin e energjisë elektrike.</i>
<i>Sigurimi shëndetësor (sigurimi)</i>	<i>Sigurimi shëndetësor bazohet në kontratë e cila nuk lidhet me njësit e prodhuara të energjisë elektrike.</i>
<i>Kostot e Administratës Qendrore</i>	<i>Kostot alokohen sipas AQ.</i>
<i>Kthimi i lejuar</i>	<i>Kjo është një kosto e njohur në MAR dhe nuk ndryshon me energji elektrike të prodhuar</i>
<i>Zhvlerësimi</i>	<i>Kjo është një kosto e kontabilitetit dhe nuk ndryshon me energji elektrike të prodhuar</i>
<i>Transporti</i>	<i>Kostot e transportit nuk ndryshojnë me njësit e prodhuara të energjisë elektrike</i>
<i>Kostot fikse të thëngjillit</i>	<i>Komponenta fikse do të përcaktohet si të hyrat e lejuara maksimale minus kostot variabile, sipas Nenit 14 paragrafit 3 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjenerimit</i>



Kategoritë e kostove variabile	Shpjegime
<i>Shpenzimet komunale&publike Gas ,ujë, energji elektrike etj</i>	<i>Kostot e shërbimeve komunale dhe tjera i referohen kostove që përdoren në prodhimin e energjisë elektrike dhe ndryshojnë me prodhimin e energjisë elektrike.</i>
<i>Riparimet dhe Mirëmbajtja</i>	<i>Riparimi përfaqëson shpenzimet e riparimit të pajisjeve të dëmtuara. Nëse nuk ka prodhim të energjisë elektrike, nuk duhet të ketë riparim të pajisjeve. Shërbimet e mirëmbajtjes përfaqësojnë koston e pajisjeve të përdorura në prodhimin e energjisë elektrike. Në parim, mund të supozohet se nuk duhet të ketë kosto kur nuk prodhohet energji elektrike.</i>
<i>Materiale dhe furnizime</i>	<i>Nëse nuk ka aktivitete, nuk duhet të ketë përdorim dhe shfrytëzim të materialeve dhe furnizimeve</i>
<i>Lubrifikuesit</i>	<i>Kostot e lubrifikimit ndryshojnë me njësit e prodhuara të energjisë elektrike.</i>
<i>Kostot e tjera</i>	<i>Kostot e tjera ndryshojnë me njësit e prodhuara të energjisë elektrike.</i>
<i>Kostot variabile të thëngjillit</i>	<i>Pjesa e kostove të thëngjillit që nuk do të shkactohej nëse prodhimi i thëngjillit do të ishte i barabartë me zero, në pajtim me Nenin 14 paragrafin 5.2 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar</i>
<i>Kostot e karburanteve</i>	<i>Kostot e karburanteve ndryshojnë me njësit e prodhuara të energjisë elektrike.</i>
<i>Kostot e bartshme OS/OT</i>	<i>Tarifat e licencës nuk ndryshojnë me njësit e prodhuara të energjisë elektrike por vetëm bëhen përshtatjet e rregullta.</i>
<i>Tarifa e licencës</i>	<i>Tarifat e licencës ndryshojnë me njësit e prodhuara të energjisë elektrike</i>

Ngarkesa për Kapacitet

Gjeneratori i rregulluar do t'i caktojë ngarkesat për kapacitet në mënyrë që ngarkesa për kapacitet të mbulojë kostot fikse të gjeneratorit të rregulluar, me kusht që kapaciteti gjenerues në dispozicion të plotësojë cakun e disponueshmërisë të caktuar për gjeneratorin e rregulluar dhe ngarkesa për kapacitet të jetë në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga gjeneratori i rregulluar dhe të aprovuar nga rregullatori. Ngarkesat për kapacitet do të shprehen në euro për njësi të kapacitetit në dispozicion për orë. Ato do të paguhen në bazë mujore për secilën orë të kapacitetit në dispozicion



për atë muaj. Asnjë ngarkesë nuk do të jetë obligative për t'u paguar nga FPEE për orët në të cilat nuk ka kapacitet në dispozicion.

Ngarkesa për kapacitet llogaritet sipas formulës:

$$\text{Tarifa (ngarkesa) per Kapacitetit (€/MW)} = \frac{\text{MAR pjesa fikse}}{\text{MW} * h \text{ ne dispozicion}}$$

Ngarkesa e gjithmbarshme për kapacitet është e barabartë me ngarkesën për kapacitet shumëzuar me numrin e orëve në dispozicion.

Në vijim po japim tabelën për përcaktuesit e ngarkesës për kapacitet për gjeneratorët e rregulluar.

Njësi	Njësitë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Viti
A3	Kapaciteti(MW)													
	Orët në dispozicion													
	Totali i kapacitetit në dispozicion													
A4	Kapaciteti(MW)													
	Orët në dispozicion													
	Totali i kapacitetit në dispozicion													
A5	Kapaciteti(MW)													
	Orët në dispozicion													
	Totali i kapacitetit në dispozicion													
B1	Kapaciteti(MW)													
	Orët në dispozicion													
	Totali i kapacitetit në dispozicion													
B2	Kapaciteti(MW)													
	Orët në dispozicion													
	Totali i kapacitetit në dispozicion													

Ngarkesa për Energji

Gjeneratori i rregulluar do të caktojë ngarkesat për energji në mënyrë që: ngarkesat për energji të mbulojnë kostot variabile të gjeneratorit të rregulluar, duke pasur parasysh njësitë që priten të prodhohen nga gjeneratori i rregulluar gjatë vitit relevant. Ngarkesat për energji do të shprehen në euro për çdo njësi të prodhuar.

Ngarkesa për energji llogaritet sipas formulës në vijim:

$$\text{Tarifa(ngarkesa) për Energji (€/MWh)} = \frac{\text{MAR pjesa variabile}}{\text{MWh e liferuara}}$$